



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 89, Datë 13.05.2024

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "ENSCO TRADING (ALBANIA)" SH.P.K.,  
NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma "d", të ligjit nr. 43/2015 "*Për sektorin e energjisë elektrike*", i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma "e", 5, pika 1, gërma "e", 13 dhe 16 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.05.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 586/18 prot., datë 10.05.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "*Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë "ENSCO Trading (Albania)" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike*",

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 35, datë 27.03.2024 vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë "ENSCO Trading (Albania)" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 136, datë 06.09.2019.
- Me vendimin nr. 67, datë 12.04.2024 u vendos zgjatja e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar në lidhje me këtë aplikimin, për shkak të kohës së pamjaftueshme për zhvillimin e korrespondencës së mëtejshme me shoqërinë, si dhe shqyrtimin e dokumentacionit që shoqëria duhet të dorëzonte në ERE.
- ERE nëpërmjet shkresës nr. 586/12 prot., datë 16.04.2024 njoftoi shoqërinë mbi vendimmarrjen si më sipër cituar, gjithashtu me shkesën nr. 586/14 prot., datë 23.04.2024 dhe shkresën nr. 586/16 prot., datë 26.04.2024 ka vijuar korrespondencën mbi dokumentacionin e mbetur të paplotësuar.

- Shoqëria me shkresën nr. 586/13 prot., datë 22.04.2024, shkresën nr. 586/15 prot., datë 24.04.2024 dhe shkresën nr. 586/17 prot., datë 26.04.2024, ka depozituar dokumentacion shtesë.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Shoqëria ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “ENSCO Trading (Albania)” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 07.09.2024.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**